



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:281569
Datë: 17.12.2020
Numri i dokumentit: 01349780

C. nr. 1013/19

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Glllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të paditëses M. Ll. nga Gjakova, përfaqësuar nga Y. B. i avokat nga Gjakova, kundër të paditurës K. Gj.-D. K. A, kontest pune - kompensim të ushqimit gjatë punës dhe shpenzime të udhëtimit, vlera kontestit 3,072.70€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07 dhjetor 2020, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurës, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT aprovohet kërkesëpadia e paditëses M. Ll. nga Gjakova dhe **DETYROHET** e paditura K. e Gj.- D.K.A. – Gjakovë që paditëses, nga data 01 janar 2015 e deri me 29 shkurt 2020 të ia paguaj;

- në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim në vendin e punës shumën prej 2,324.00€ (dymijë e treqind e njëzet e katër euro),
- në emër të shpenzimeve të udhëtimit në punë shumën prej 524,13€ (pesëqind e njëzet e katër euro e trembëdhjetë centë dhjetë) shumën e përgjithshme 2,848.13€ (dymijë e tetëqind e katër dhjetë e tetë euro e trembëdhjetë centë) me kamatë ligjore prej 8% nga data e kryerjes së ekspertimit 16 nëntor 2020 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 508.00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

PËRTEJ shumës së aprovuar kërkesa në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 30% në lartësi prej 224.63€ u **REFUZUA SI E PA BAZUAR**.

A r s y e t i m

Paditësja me padi, parashtrësja dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar se është e punësuar si mësimdhënëse e lëndës së gjeografisë në Institucionin Arsimor “ H. D.” në Gjakovë, pranë D. K. të A. në Gjakovë.

E paditura, në bazë të nenit 36 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK me datë 11 prill 2014, dhe në bazë të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK me datë 18 prill 2017 obligohet që punëtorëve

të arsimit, përkatësisht edhe këtu paditëses M. Ll. ka për obligim të ia kompensoj ushqimin gjatë orarit të punës dhe atë 2.00€ për çdo ditë paraqitur në punë.

Për kundër detyrimeve të cilat e paditura ka konform Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe Kontratës Kolektive të lartë cekura, e paditura nuk ka përmbush obligimet e përcaktuar me kontrata kolektive të lartë cekura, për kompensimin e paditëses për ushqim gjatë punës.

Paditësja gjatë vitit shkollor 2014/2015, përkatësisht nga data 01 janar 2015 ka vijuar punë për 141 ditë; vitin shkollor 2015/2016 ka vijuar punën për 226 ditë; vitin shkollor 2016/2017 ka vijuar punën për 223 ditë; vitin shkollor 2017/2018 ka vijuar punën për 223 ditë; vitin shkollor 2018/2019 ka vijuar punën për 224 ditë; vitin shkollor 2019/2020 deri në momentin e paraqitjes së padisë ka vijuar punën për 61 ditë, gjithsejtë 1098 ditë pune.

Paditëses nuk i është paguar kompensimi për ushqim në punë, për gjithsejtë 1098 ditë pune, ashtu që duke pas parasysh që e paditura ka obligim të paguajë nga 2.00€ për çdo ditë të paraqitjes në punë, i bie që paditëses në emër të kompensimit të pagesës për ushqim në punë për 1098 ditë pune, e paditura i ka borxh shumën prej 2,196.00€, ndërsa deri me datën 29 shkurt 2020 ka gjithsejtë 1162 diti të pranisë në punë.

Me precizimin e kërkesëpadisë pas kryerjes së ekspertimit financiar ka kërkuar që paditëses për periudhën 01 janar 2015 deri me datë 29 shkurt 2020 ti kompensohen shpenzimet e transportit, duke u bazuar në rrethanën se paditësja ka punuar në fshatin Ponoshec dhe Bishtazhin për atë e paditura i ka borxh shumën e kërkuar në lartësi prej 748.76€.

Sa i përket përgjigjes në padi është ushtruar pas afatit të përcaktuar ligjor, përmbajtja e të njëjtës është tërësisht deklarative, kundërshtimet e parashtruara në atë përgjigje nuk kontestojnë bazën dhe lartësinë e kërkesës, por që e paditura si arsyetim ka theksuar vetëm mënyrat organizative të buxhetit të shtetit që në rastin konkret për paditësen nuk janë relevante.

I autorizuari i paditëses në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në këtë çështje juridike me siguri është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura qysh para vitit 2015. Me ekspertizën e ekspertit financiar është bazuar në të gjeturat për ditët e vijueshmërisë së punës dhe vërtetimit të Shoqatës së Transportit të Udhëtarëve nga është vërtetuar lartësia e kërkesë padisë. U propozua që kërkesëpadia e precizuar të aprovohet në tërësi.

Shpenzimet procedurale u kërkuar për taksë gjyqësore 30.00€, për përpilim të padisë shumën 104.00€, për përpilim të parashtrësës së datës 09 qershor 2020 shuma 104.00€, për përfaqësim në tri seanca nga 135.20€, për ekspertizë shumën 81.76€ gjithsejtë shumën prej 725.36€.

E paditura ka paraqit përgjigje në padi jashtë afatit ligjor. Me te ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar dhe ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar me datë 18 prill 2017 në mes të A. B. ish Ministër i Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë dhe Rr. J., Kryetar i SBSHK-ut njoftojnë se përkundër nenit 46 të asaj Kontrate, nga ana e MASHT-it dhe SBASHK-ut nuk janë angazhuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos

buxhetore për zbatimin e asaj Kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit.

Po ashtu në bazë të Qarkores Buxhetore 2020/01, numër 777 datë 15 maj 2019 të lëshuar nga B. H. ish Ministër i Financave në Grantin Specifik për Arsim Parauniversitar ku vetëm është paraparë në pikën q) kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto 1.4 milion euro dhe nuk është paraparë kurrfarë obligimi për shpenzimet e shujtës ditore për punonjësit arsimor gjë që i bie e pa implementueshme në aspektin financiar për realizimin e kërkesës së paditëses në rastin konkret si dhe me dispozitën kalimtare të nenit 46 paragrafi 1 të Kontratës Kolektive të saj citim “MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për të informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 dhe nenin 46 paragrafi 2 të saj” citim “MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenet 35 paragrafi 5,7 dhe 9 brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare”. Kërkesa e paditëses në rastin konkret nuk ka qenë e paraparë edhe me Qarkoren 2017/01 datë 13 maj 2016, numër 966 e ish Ministrit të Financave Avdullah Hoti ku ndër të tjera në Grantin Specifik për Arsimin Parauniversitar për vitin 2017 nuk është paraparë kurrëfarë obligimi për shpenzimet e shujtës ditore për punonjësit arsimor. Po ashtu edhe në Qarkoren buxhetore 2019/01 datë 15 maj 2018 numër 950 lëshuar nga B. H. ish Ministër i Financave ka qenë e paraparë pika q) kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto 1 milion euro. Bazuar në Qarkoret e lartë shënuara nuk është paraparë implementimi i nenit 35 paragrafi 5 dhe 7 i Kontratës Kolektive.

Shqyrtimin kryesor të treguar me datë 07 dhjetor 2020 Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt dhe me propozimin e të autorizuarit të paditëses, sipas nenit 423.4 të LPK-së.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave: Kontratës së punës të datës 01 shtator 2015, vërtetimit të Gjimnazit “H. D.” Gjakovë nr.157 datë 25 shtator 2020, vërtetimit pa datë të Shoqatës së Transportit të Udhëtarëve - Gjakovë pa datë, listës së pagave për muajin janar 2020, ekspertizës financiar të ekspertit K. Q. ekonomist i diplomuar datë 16 nëntor 2020, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesëpadia e precizuar është pjesërisht e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Nga Kontrata e Punës vërtetohet se paditësja në cilësi të mësimdhënëses së lëndës së gjeografisë në Gjimnazin “H. D.” Gjakovë ka lidh kontratë pune me të paditurën në cilësi të punëdhënëses me datën 01 shtator 2015 në kohëzgjatje të përhershme me 40 orë pune në javë.

Me vërtetimit nr. 154 të datës 25 shtator 2020 të asaj Shkolle provohet se paditësja si mësimdhënëse e lëndës së gjeografisë ka vijuar punën në Gjimnazin “H. D.” në Gjakovë dhe në degët në Ponohec dhe Bishtazhin të komunës së Gjakovës dhe atë:

në vitin shkollor 2014/2015 nga data 01 janar 2015 deri në përfundim të vitit shkollor ka vijuar 141 ditë të pranisë në punë, nga ato ditë mësimdhënësjë dy ditë punë ka punuar në Gjimnazin “H. D.” në Gjakovë, dy ditë punë ka punuar në degën në Bishtazhin dhe një ditë punë ka punuar në degën në Ponohec, komuna e Gjakovës.

Në vitin shkollor 2015/2016 ka vijuar 226 ditë të pranisë në punë, nga ato ditë mësimdhënësja një ditë pune ka punuar në Gjimnazin "H. D." në Gjakovë, tri ditë pune ka punuar në }degën në Bishtazhin, komuna e Gjakovës, një ditë pune ka punuar në degën në Ponoshec, komuna e }Gjakovës.

Në vitin shkollor 2016/2017 ka vijuar 223 ditë të pranisë në punë, nga ato ditë mësimdhënësja tri ditë pune ka punuar në Gjimnazin "H. D." në Gjakovë, një ditë punuar në punuar në degën Bishtazhin, një ditë pune ka punuar në degën në Ponoshec.

Në vitin shkollor 2017/2018 ka vijuar 223 ditë të pranisë në punë, nga ato ditë mësimdhënësja tri ditë pune ka punuar në Gjimnazin "H. D." në Gjakovë, një ditë pune ka punuar në degën Bishtazhin, një ditë pune ka punuar në degën Ponoshec.

Në vitin shkollor 2018/2019 ka vijuar 224 ditë të pranisë në punë, nga ato ditë mësimdhënësja katër ditë pune ka punuar në Gjimnazin "H. D." në Gjakovë, një ditë pune ka punuar në degën Bishtazhin.

Për vitin shkollor 2019/2020 deri me 29 shkurt 2020 ka vijuar 125 ditë të pranisë në punë, vetëm në Gjakovë. Gjithsejtë paditësja ka 1162 ditë të pranisë në punë.

Nga Vërtetimi i Shoqatës së Transportit të Udhëtareve vërtetohet se çmimi i biletës në relacionin Gjakovë-Ponoshec është 1.30€ në një drejtim ndërsa në relacionin Gjakovë-Bishtazhin është 0.50€ në një drejtim.

Nga lista e pagave e muajit janar 2020 vërtetohet se paditësja ka realizuar pagën primare si mësimdhënëse dhe është anëtare e SBASHK-ut.

Paditëses për 1162 ditë të pranisë në punë i takon nga dz eor për çdo ditë, gjithësejtë shuma 2,324.00 €.

Nga ekspertiza financiare ekspertit K. Q. ecc.i diplomuar, pas llogaritjeve të kryera lidhur me numri e ditëve të pranisë në punë të paditëses për vitin shkollor 2014/2015 që në total janë 141 ditë, nga këto ditë 56 ditë të punës ka qenë në Gjakovë, 57 ditë të punës në fshatin Bishtazhin dhe 28 ditë pune në fshatin Ponoshec.

Në vitin shkollor 2015/2016 gjithsejtë ka 226 ditë të pranisë në punë, 45 ditë në Gjakovë, 136 ditë në Bishtazhin dhe 45 ditë në Ponoshec.

Në vitin shkollor 2016/2017 gjithsejtë ka 223 ditë të pranisë në punë, 134 ditë në Gjakovë, 44 ditë në Bishtazhin dhe 45 ditë në Ponoshec.

Në vitin shkollor 2017/2018 gjithsejtë ka 223 ditë të pranisë në punë, 134 ditë në Gjakovë, 44 ditë në Bishtazhin dhe 45 ditë në Ponoshec.

Në vitin shkollor 2018/2019 gjithsejtë ka 224 ditë të pranisë në punë, 179 ditë në Gjakovë, 45 ditë në Bishtazhin dhe asnjë ditë në Ponoshec.

Në vitin shkollor 2019/2020 gjithsejtë ka 125 ditë të pranisë në punë, të gjitha këto ditë pune në Gjakovë.

Nga qyteti i Gjakovës deri në fshatin Bishtazhin për një drejtim çmimi biletës është 0.50€, bazuar në Vërtetimin e Shoqatës së Transportit e Gjakovës ashtu që paditësja në fshatin Bishtazhin gjatë vitit shkollor 2014/2015 ka 57 ditë të pranisë në punë, shuma e udhëtimit për dy drejtime është 1.00€, në vlerë 56.40€. për vitin shkollor 2015/16 janë gjithsejtë 136 ditë pune gjithsejtë shuma 135.60€, për vitin shkollor 2016/2017 janë 44 ditë të pranisë në punë shuma 44.60€. Vitin shkollor 2017/2018 janë 44 ditë të pranisë në punë shuma 44.60€, për vitin 2018/2019 janë 45 ditë shuma 44.80€ dhe për periudhën 01 janar 2015 deri me 29 shkurt 2020 obligimet e transportit për në fshatin Bishtazhin janë në shumë 326.00€.

Nga qyteti i Gjakovës deri në fshatin Ponoshec për një drejtim çmimi biletës është 1.30€ bazuar në Vërtetimin e Shoqatës së Transportit e Gjakovës ashtu që paditësja në fshatin Ponoshec gjatë vitit shkollor 2014/2015 ka 28 ditë të pranisë në punë, shuma e udhëtimit për dy drejtime është 2.60€ në vlerën 73.32€. Për vitin shkollor 2015/16 janë gjithsejtë 136 ditë pune shuma 117.52€, për vitin shkollor 2016/2017 për 45 ditë të pranisë në punë shuma 115.96€. Vitin shkollor 2017/2018 janë 45 ditë të pranisë në punë shuma 115.96€, për vitin 2018/2019 dhe vitin 2019/2020 nuk ka asnjë ditë pune në fshatin Ponoshec. Për periudhën 01 janar 2015 deri me 29 shkurt 2020 obligimet e transportit për në fshatin Ponoshec janë në shumë 422.76€. Shpenzimet e udhëtimit për dy relacionet Gjakovë- Bishtazhin dhe anasjelltas janë në shumën 326.00€, në relacionin Gjakovë- Ponoshec dhe anasjelltas janë 422.76€ gjithsejtë shuma prej 748.76€.

Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e nënshkruar në mes të SBASHK-ut dhe MASHT-it me datë 11 prill 2014, e cila për implikimet financiare ka filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 sipas nenit 36.8 përcakton se të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është së paku dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete. Kjo kontratë është e zbatueshme deri me datë 18 prill 2017. Neni 36.6 i të njëjtës Kontratë përcakton se mësimdhënësve që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.

Pas datës 18 prill 2017 e deri me datë 29 shkurt 2020 është i zbatueshëm neni 35.7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë që ka hyrë në fuqi nga data 18 prill 2017 me të cilin të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2.00€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Neni 35.5 i të njëjtës Kontratë rregullon çështjen e punonjësve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.

Paditësja për periudhën nga data 01 janar 2015 deri me datë 29 shkurt 2020 ka gjithsejtë 1162 ditë të pranisë në punë, për këtë i takon nga 2.00€ në ditë, gjithsejtë shuma 2,324.00€. Sa i përket shpenzimeve të udhëtimit në fshatin Bishtazhin 326 ditë pune e që shuma e tërësishme e udhëtimit Gjakovë- Bishtazhin dhe anasjelltas është 1.00€, në shumën e tërësishme 326.00€. Paditëses nga kjo shumë i takon vetëm 70%, shuma 228.20€. Në drejtimin Gjakovë- Ponoshec dhe anasjelltas ka gjithsejtë 163 ditë pune, çmimi në një drejtim është 1.30€, gjithsejtë shuma 422.76€. Paditëses i takon vetëm 70% e kësaj shume, shuma 295.93€. Shuma e tërësishme e shpenzimeve të transportit 748.76€ paditëses i takon shuma prej 524.13€.

Përtej shumës së kërkuar kërkesa në emër të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi prej 30% në shumë 224.63€ është pa mbështetje ligjore dhe u refuzua si e pabazuar.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. Sipas nenit të lartë cituar është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e ushqimit, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se “ Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën e që lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Paditëses i takon kamata e kërkuar nga data ekspertimit 16 nëntor 2020 për shkak të rënies në vonesë të paditurës për përmbushjen e detyrimit të saj, sa i përket ushqimit të kërkuar.

Me rastin e vendosjes Gjykata murr parasysh pretendimet e palës së paditur paraqitur në përgjigje në padi, por u konsideruan pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje. Lidhur me mos koordinimin institucional, siç janë Qarkoret e përmendura të Ministrive përkatëse pala paditëse nuk mund të pësoj nga fakti se Kontratat Kolektive kanë qenë në fuqi dhe të zbatueshme.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA ku paditëses i ka njohur të drejtën e shpenzimeve procedurale për taksë gjyqësore shumë 30.00 €, për përpilim të padisë shumë 104.00€, përpilim të parashtrësës shumë 104.00€, përfaqësim në dy seanca nga 135.20€, shpenzimet ekspertizës 81.76€, në shumë të përgjithshme 589,76€. Shpenzimet e kërkuar për sencën e datës 05 tetor 2020 u refuzuan sepse parashtrësës së datës 01 tetor 2020 i janë bashkangjitur provat dhe për seancën e datës 5 tetor 2020 nuk ka pas kushte ligjore për mbajtje për shkak të afatit të shkurtë ligjor.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 1013/19, datë 07 dhjetor 2020

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada Glllogjani

UDHËZIM JURIDIK; Kundër këtij Aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.